

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 692. date 27.12.2002**

**PER DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 288, DATE 18.6.1999**  
**TE KESHILLIT TE MINISTRAVE, "PER MIRATIMIN E DOKUMENTIT**  
**TE POLITIKES SE ZHVILLIMIT TE TELEKOMUNIKACIONEVE NE**  
**REPUBLIKEN E SHQIPERISE"**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 4 te ligjit nr. 8618, date 14.6.2000 "Per telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise", me propozimin e Ministrit te Transportit dhe te Telekomunikacionit, Keshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve, qe i bashkelidhen ketij vendimi, ne dokumentin e politikës se zhvillimit te telekomunikacioneve ne Republiken e Shqiperise, miratuar me vendimin nr. 288, date 18.6.1999 te Keshillit te Ministrave.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve per zbatimin e ketij vendimi.  
Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Fatos Nano

## **NDRYSHIMET NE DOKUMENTIN "POLITIKA E ZHVILLIMIT TE TELEKOMUNIKACIONEVE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE"**

Pika 2 "Objektivat afatmesme", objektivi "Ne vitin 2003 te rritet ne 450 000-500000 (qe i korrespondon nje penetrim telefonik rreth 15% ) numri i linjave telefonike ne pune ne gjithe vendin" , ndryshohet si me poshte vijon:

"Ne vitin 2005 te rritet ne 450000-500000 (qe i korrespondon nje penetrim telefonik rreth 15%) numri i linjave fikse telefonike ne pune ne gjithe vendin".

Pika 3 "Struktura e tregut te telekomunikacioneve", paragrafi i shtate, ndryshohet si me poshte vijon:

"Ky model i liberalizimit gradual, qe i lejon operatorit kombetar ekzistues nje periudhe te kufizuar ekskluziviteti gjate se ciles ai do te investoje dhe ribalancoje tarifat, eshte ndjekur edhe nga vendet e tjera evropiane. Qeveria parashikon qe, pasi te jete bere nje progres i konsiderueshem me investimet ne rrjetet vendore, urbane dhe rurale, si dhe te jene rregulluar tarifat, te mundesahet liberalizimi i sherbimeve baze" .

Pika 4 "Privatizimi" , paragrafi i peste, ndryshohet si me poshte vijon: "Si kompensim te angazhimeve per investimet e pershkruara me siper, Albtelecom-it do t'i jepet nje e drejte ekskluzive per te ofruar sherbime telefonike kombetare e nderkombetare dhe sherbime telefonike lakale ne zanat urbane bazuar ne rrjetin e tij per nje periudhe te pakten deri ne 30 qershar 2003.

Nderkohe do te ndermerren te gjitha hapat e nevojshem per te bere te mundur qe ne fund te kesaj periudhe operatori Albtelecom te jete i gatshem per privatizim, si dhe do te percaktohet plani i veprimit per liberalizimin e plote te tregut te telekomunikacioneve" .

Pika 8 "Politika e licensimit per sherbimet publike", paragrafi i trete, ndryshohet si me poshte vijon:

"Procedurat e licensimit do te zbatohen ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Qeveria do te percaktoje numrin e licencave qe do te jepen per sherbimet e klasifikuara ne kategorine e pare te tabeles se permendur me siper. Edhe me hapjen e plate te tregut te telekomunikacioneve per konkurrence, disa sherbime do te vazhdojne te ekzistojne ne kete kategori, ku numri i licencave eshte i kufizuar. Nje klasifikim i tille do te behet per ato sherbime qe perdorin burime te kufizuara natyrate, siç jane frekuencat. Ne kete rast, ERT do te ndermarre studimin e brezave te frekuencave qe jane caktuar per sherbime publike te telekomunikacioneve me destinacion lidhjen e perdoruesve me pajisjet kumtuese, konform percaktimeve te Planit Kombetar te Radiofrekuencave dhe rekomandimeve nderkombetare, dhe brenda gjashtemujorit te dyte te vitit 2003 do te paraqese per miratim ne Keshillin e Ministrave kriteret dhe procedurat e licensimit".

Ne tabelen e aneksit 1 "Klasifikimi i sherbimeve te telekomunikacioneve per qellime licensimi", rreshti i dyte i klases A "Sherbime telefonike kombetare", kolona e trete, "Komente mbi procedura e licensimit", ndryshon si vijon:

"Vetem Albtelekom (te pakten deri ne 30 qershor 2003)"

ne klases A " Sherbime telefonike kombetare" shtohet rrethi si vijon:

### 3.Kombetare dhe lokale

Sherbime publike fikse, qe perdorin teknologjine pa tela, te njohura me termin "rrjeti lokal pa tela" Albtelekom, te tjeret me tender te hapur nderkombetar

Ne aneksin 2 "Glosari i termave te telekomunikacioneve te perdorur ne kete politike" shtohet, ky perkufizim:

Rrjeti lokal pa tela Lidhja (et) e perdoruesve ne rrjetin telekomunikacioneve, jo nepermjet kablove, por nepermjet shfrytezimit te pajiseve radio.